



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AM&BM Sh.P.K." të datës 27.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "21 Furnizimi me Pelet per ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te bashkësitë lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5512-1-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AM&BM Sh.P.K." të datës 27.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "21 Furnizimi me Pelet per ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te bashkësitë lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5512-1-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AM&BM Sh.P.K." (tutje "parashtruesi") me datë 27.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "21 Furnizimi me Pelet per ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-te bashkësitë lokale dhe nevojat tjera Komunale" me nr. të prokurimit 616-25-5512-1-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Kronologjia e ngjarjes për aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Pelet për nevojat e SP", me nr. të prokurimit 70030-25-4657-1-1-1 Kërkesë për Rishqyrtim lidhur me shkeljet e Ligjit për Prokurim Publik dhe konfliktin e interesit të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit nga DKA për aktivitetin e prokurimit "21 Furnizimi me Pelet për ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-të, bashkësitë lokale dhe nevojat tjera komunale", me nr. i prokurimit: 616-25-5512-1-1-1.

Bazuar në Ligjin për Prokurim Publik (LPP) si dhe në pajtim me Rregulloren për Prokurim Publik, ne, si Operator Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit të lartcekur, paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim për arsye të veprimeve të kundërligjshme dhe shkeljes së parimeve të prokurimit nga Komisioni i Vlerësimit, anëtarët e DKA-së, respektivisht nga znj. Arlinda Cakiqi. Gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, OE "AM&BM SH.P.K" është trajtuar në mënyrë diskriminuuese dhe të padrejtë, për shkak të:

- interesave personale të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit nga DKA-së (znj. Arlinda Cakiqi) të cilët kanë shkelur detyrat zyrtare gjatë procesit të vlerësimit;
- trajtimit të pabarabartë të operatorëve ekonomikë gjatë vizitës në depo;
- devijimit nga qëllimi i vizitës në terren;
- zbulimit të informatave konfidenciale të OE AM&BM SH.P.K tek konkurrentët; dhe
- veprimeve që cenojnë integritetin e procesit të prokurimit publik.

Në kuadër të aktivitetit të prokurimit të lartpërmendur, Komisioni i Vlerësimit ka realizuar një vizitë në depo të OE AM&BM SH.P.K me qëllim të verifikimit të sasisë së peletit, sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Gjatë kësaj vizite:

1. Gjatë vizitës në depon e OE AM&BM SH.P.K, përfaqësuesit ju kanë ofruar Komisionit të Vlerësimit qasje të pakufizuar në numerimin dhe verifikimin e sasisë së kërkuar të peletit.

Znj. Arlinda Cakiqi dhe anëtarët tjerë të Komisionit të Vlerësimit nga DKA nuk kanë vepruar sipas detyrave dhe përgjegjësiave të tyre ligjore për ta verifikuar sasinë e peletit, ndonëse ky ishte qëllimi kryesor i vizitës, por znj. Cakiqi ka kërkuar kontratën apo dëshmi për posedimin e depos, dokument i cili nuk është kërkuar,

në dosjen e tenderit dhe as në kriteret e kualifikimit të përcaktuara në njoftimin për kontratë.

3. Gjatë vizitës, znj. Cakiqi dhe anëtarët tjerë të Komisionit të Vlerësimit nga DKA ka ushtruar presion ndaj përfaqësuesve të OE AM&BM SH.P.K, duke kërkuar dokumente që tejkalojnë kërkesat ligjore dhe teknike të aktivitetit të prokurimit, duke shfaqur sjellje joprofesionale dhe të papërshtatshme për një Komision të Vlerësimit. Këto veprime kanë krijuar klimë jo profesionale, të tensionuar dhe trajtim të pabarabartë ndaj OE AM&BM SH.P.K, krahasuar me operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit.

4. Sikurse në çdo depo tjetër, edhe në depon e OE AM&BM SH.P.K ka një gamë të gjerë të llojeve të peletit. Gjatë vizitës në depo, Komisioni i Vlerësimit ka kërkuar që të hapet vetëm një paketim i peletit, i cili nuk ishte i llojit të kërkuar në aktivitetin e prokurimit "21 Furnizimi me Pelet për ngrohjen e objekteve arsimore, AMF-të, bashkësitë lokale dhe nevojat tjera komunale", me nr. të prokurimit 616-25-5512-1-1-1. Përfaqësuesit e OE AM&BM SH.P.K i kanë kërkuar Komisionit të Vlerësimit që të hapen paketimet e peletit të llojit të specifikuar nga Komuna e Prishtinës, por komisioni me qëllim nuk ka pranuar të testojë paketimet e tjera. Zgjedhja e mostrës së peletit të një

Iloji tjetër është bërë qëllimisht nga anëtarët e DKA-së, me qëllim që të krijohet përshtypja e gabuar për cilësinë dhe për të diskualifikuar OE AM&BM SH.P.K. Në këtë mënyrë, Komisioni i Vlerësimit ka vepruar në mënyrë tendencioze, duke devijuar nga qëllimi i vizitës dhe duke vepruar në kundërshtim me parimet e drejtësisë, objektivitetit dhe barazisë në prokurim publik.

5. Sipas informacioneve që ne i kemi Znj. Cakiqi kundërligjshëm ka komunikuar me një nga operatorët konkurrues në këtë aktivitet të prokurimit Bek Fluids L.L.C., duke i zbuluar informata konfidenciale lidhur me procesin e vlerësimit dhe duke e këshilluar që të ndikojë tek furnitori i AM&BM SH.P.K për të penguar furnizimin me pelet deri në ditën e vizitës, me qëllim që AM&BM SH.P.K të mos ketë sasinë e kërkuar dhe të diskualifikohet.

6. Sipas aprovimit të Zyrës së Prokurimit për zgjatjen e afatit për vizitë në depo, vizita në depon e AM&BM SH.P.K ishte përcaktuar për datën 07.10.2025 dhe OE AM&BM SH.P.K. ishte pajtuar. Megjithatë, vizita nuk është realizuar në këtë datë, por një javë më vonë, më 15.10.2025. Kjo vonesë është bërë me qëllim që OE i propozuar për dhënien e kontratës të ndikojë tek furnitorët për të penguar furnizimin me pelet të OE AM&BM SH.P.K. Gjatë kësaj periudhe, përfaqësues të Bek Fluids L.L.C. kanë kontaktuar furnitorët e OE AM&BM SH.P.K, duke kërkuar nga ta që të mos e furnizojnë me pelet. Pra, në njërën anë Komisioni i Vlerësimit e ka prolonguar vizitën në depot e OE AM&BM SH.P.K, ndërsa në anën tjetër i ka dhënë informacione, OE të propozuar për dhënien e kontratës Bek Fluids L.L.C. për ta dëmtuar OE AM&BM SH.P.K.

7. OE AM&BM SH.P.K ka ofertuar me çmim më të ulët prej 49,600 euro krahasuar me OE-në e propozuar për dhënien e kontratës, duke shkaktuar kështu dëm të drejtpërdrejtë buxhetit të Komunës si pasojë e vlerësimit të padrejtë nga Komisioni”.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsytet si në vijim:

ARSYETIM

Komisioni i vlerësimit pas shqyrtimit, krahasimit dhe ekzaminimit të ofertës njofton si në vijim:

Oferta juaj është vlerësuar si e papërgjegjshme, për këto arsye:

Gjatë procesit të verifikimit të stokut me pelet në depo, në përputhje me kërkesat për kapacitetin teknik dhe profesional (pikat 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit), është shqyrtuar kërkesa si më poshtë:

Kërkesa 1. Ofertuesi të ketë stok minimumi 70% të sasisë totale të kërkuar nga adresa që ofrohet (stokun dhe malimin të vërtetë komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave).

Dëshmia 1. Deklaratë me shkrim e vërtetë dhe nënshkruar se posedon produktin e kërkuar, prej 70% të sasisë.

Operatori Ekonomik për këtë pikë është i pa përgjegjshëm pasi që nuk ka arritur të dëshmojë se posedon sasinë prej 70% të kësaj komisioni pas vizitës në teren ka konstatuar se operatori ekonomik nuk i posedon 70% të sasisë së kërkuar të peletit në stok të certifikuar nga prodhuesi sipas deklaratis që është paraqitur në ofertë nga kompania BEKOM CO DOO, me adresë në Bixce 60, ku në depo komisioni gjatë verifikimit ka vërejtur se janë tri lloje të peletit dhe një sasi e vogël sipas deklaratis se dorëzuar nga kompania BEKOM CO DOO, me adresë në Bixce 60, Podgorica, Mali i Zi, andaj kjo oferte është e pa përgjegjshme sepse nuk ka arritur të dëshmojë sasinë e kërkuar sipas deklaratis së dhënë.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 11.11.2025

Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimi të këtij vendimi.